



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo

ZYRA E RREGULATORIT PËR ENERGJI
REGULATORNI URED ZA ENERGIJU
ENERGY REGULATORY OFFICE



VLERËSIMI I KONCENTRIMIT TË TREGUT TË ENERGJISË ELEKTRIKE NË KOSOVË PËRMES INDEKSIT HHI
(HERFINDAHL–HIRSCHMAN INDEX) PËR VITIN 2022

Prishtinë, shkurt 2023



Zyra e Rregullatorit për Energji, bazuar në detyrat dhe funksionet e përcaktuara në Ligjin për Rregullatorin e Energjisë Nr.05/L_084, në mes tjerash bënë edhe vlerësimin e konkurrencës në tregun me shumicë dhe atë me pakicë të energjisë elektrike në vend.

Prezenca e konkurrencës në tregun e brendshëm vlerësohet duke krahasuar gjendjen ekzistuese të tregut me kërkesat ligjore sipas legjislacionit primarë dhe sekondar të sektorit të energjisë në Kosovë, aplikimin e indikatorit për matjen e përqendrimit të tregut Herfindahl - Hirschman (HHI), përfshirë edhe vendimin e Bordit të ZRRE-së V_342_2011 për Kriteret për Vlerësimin e Konkurrencës në Furnizim me Energji Elektrike në Kosovë.

ZRRE, vitin e kaluar ka publikuar dokumentin Vlerësimi i konkurrencës në tregun e energjisë elektrike në Kosovë 2020-2021 përmes të cilit ka vlerësuar nëse ka konkurrencë efektive në tregun e energjisë elektrike me shumicë dhe pakicë, si dhe ka paraqitur karakteristikat e tregut që mund të dëmtojnë konkurrencën efektive.

Për ta vlerësuar nivelin e konkurrencës në tregun e energjisë elektrike në vend, përveç tjerash, është aplikuar edhe indeksi Herfindahl - Hirschman (HHI), i cili matë përqendrimin e tregut. Rezultatet e përfituara nga HHI në dokumentin Vlerësimi i Konkurrencës në Tregun e Energjisë Elektrike në Kosovë 2020-2021, për tregun e energjisë elektrike me shumicë për vitin 2020 ka rezultuar me vlerën 9,021, dhe për vitin 2021 me vlerën 9,070, dhe për tregun e energjisë elektrike me pakicë 2020-2021 kanë rezultuar me vlerën 10,000. Këto vlera tregojnë se ekziston përqëndrim shumë i lartë në tregun me shumicë dhe atë me pakicë, që nënkupton se tregu i energjisë elektrike në vend ballafaqohet me mungesë të konkurrencës. Duke pasur parasysh se dokumenti i lartëpërmendur nuk përfshinë vitin 2022, DTE ka bërë matjet e përqendrimit të tregut me shumicë dhe atij me pakicë përmes indeksit HHI duke shfrytëzuar të dhënat nga realizimi i vitit 2022.

Indeksi Herfindahl-Hirschman mat përqendrimin e tregut të kompanive kryesore në tregun e Energjisë në Kosovë, dhe në rastin tonë është matur bazuar në të dhënat të pjesëmarrësve të tregut, në atë formë duke ndarë në katror pjesën e tregut të ndërmarrjeve konkurruese që i përkasin tregut të energjisë dhe më pas duke mbledhur katrorët e tyre. Indeksi matet në pikë - çdo vlerë mbi zero dhe deri në 10,000 pikë është një vlerë e pranueshme për HHI.

Klasifikimi i tregjeve behet në tre lloje:

Tregjet e pakoncentruara: HHI nën 1500

Tregjet e përqendruara mesatarisht: HHI midis 1500 dhe 2500

Tregjet shumë të përqendruara: HHI mbi 2500

Më poshtë janë paraqitur rezultatet nga të dhënat e realizuara nga pjesëmarrësit e tregut në Kosovë për vitin 2022:




Ndërmarrja		% e pjesëmarrjes në treg	% e pjesëmarrjes në treg ²
1	KESCO	99.33	9,866.64
2	KEK	0.02	0.00
3	FET	0.65	0.42
		HHI	9,867

Bazuar në këto të dhëna, është implemtuar dhe kalkuluar HHI rezultatet e të cilit gjinden më poshtë.

Përvec furnizimit, HHI është matur edhe tek Prodhimi, ku duke përdorur të dhënat më poshtë, është nxjerr rezultati i HHI për përqendrimin e tregut me shumicë.

Ndërmarrja		% e pjesëmarrjes në treg	% e pjesëmarrjes në treg ²
1	KEK	89.91	8,083.83
2	SOWI	4.36	18.98
3	KITKA	1.39	1.93
4	Ujmani	1.23	1.52
.	.	.	.
.	.	.	.
26	.	.	.
		HHI	8,085

Nga rezultatet e përfituara nga Indeksi për Matjen e Përqendrimin të Tregut (HHI), rrjedh se për tregun e energjisë elektrike me shumicë indeksi HHI ka vlerën 8,085, kurse për tregun e energjisë elektrike me pakicë ka vlerën 9,867, me ç'rast, bazuar në standartet e HHI, është konstatuar se edhe për vitin 2022 përqendrimi në tregun e energjisë me shumicë dhe me pakicë është shumë i lartë, që nënkupton se tregu i energjisë elektrike në vend edhe në këtë vit ballafaqohet me mungesë të konkurrencës.



Diagrami më lartë paraqet klasifikimin e tregut sipas vlerave të indeksit HHI si dhe përqendrimin e tregut të energjisë elektrike në vend për periudhën 2022.

Nga rezultatet e përfituara nga Indeksi për Matjen e Përqendrimin të Tregut (HHI) për vitet 2020-2021 dhe për vitin 2022 si dhe bazuar në klasifikimin e tregjeve sipas këtij indeksi, shihet se tregu i energjisë elektrike në Kosovë në këtë periudhë është me përqendrim të lartë dhe ballafaqohet me mungesë të konkurrencës.

Për të përfituar pasyqir sa më të qartë rreth përqendrimin të tregut, ZRRE ka zhvilluar një anketë me furnizuesit e licencuar në Kosovë, me anë të së cilës ka arritur të nxjerr rezultate lidhur me nivelin e konkurrencës në treg.

Rezultatet e fituara nga ky anketim tregojnë qartë se kemi të bëjmë me një përqendrim të lartë në tregun e energjisë elektrike, nga ku shihet mungesa e Furnizuesve aktiv si dhe dominimi i tregut nga një furnizues.